



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:024683
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05609696

AC-I-24-0228

Në ankesën e

Paditësja/ ankuesja

Ndërmarja Shoqërore - NSH"Jugoauto " (në likudim), Prishtinë të cilën e përfaqëson Kryesuesi i Autoritetit të Likudimit (AL) M S, në emer të **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kundër

Të paditurit

- A G**, nga Prishtina.
- F R**, përfaqësuar nga avokati T F Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-24-0012 të datës 04 mars 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-III-24-0012 i datës 04 mars 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Paditësja më 22 janar 2024, parashtrori padi me propozimin për lëshimin e Masës se sigurisë (në tekstin në vijim MS). Me padi ajo kërkon anulimin e Kontratës së shitblerjes e lidhur në mes të NSH " Grading" dhe të paditurit 1, A G, nr.... datë . prill si dhe vërtetimin e së drejtës së pronësisë të njësisë kadastrale nr....., Zona kadastrale Prishtinë, (në tekstin në vijim prona kontestuese).

Me propozimin për lëshimin e MS, kërkoj që të urdhërohen të paditurit që mos të ndërmarrin asnjë veprim në pronën kontestuese e gjerë në zgjidhjen përfundimtare lidhur me çështjen. Paditësja pohon se në bazë të informacioneve të cilat i disponojnë, i padituri 2, A Xh G është shfrytëzues i pronës kontestuese dhe atë e dëshmon me certifikatën e pronësisë si dhe Aktvendimin nr.03/1016/23 datë 20 maj 2023. Sipas paditëses, fillimisht i padituri 1, A G, e ka regjistruar pronën konstatuese në emër të tij dhe atë në bazë të Kontratës së Shitblerjes, të vërtetuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë nr.... datë . prill, kontratë kjo e lidhur në mes të tij dhe NSH "Garding". Paditësja tutje pohon se prona kontestuese është pronë e NSH " Jugoauto" si dhe NSH " Grading". Paditësja tutje pohon se prona kontestuese përfshihet në ngastrën kadastrale nr... Zona Kadastrale Prishtinë. Paditësja me padi lidhur me të drejtën e administrimit të NSH i referohet dispozitave ligjore të Ligjit për AKP si dhe Shtojcës së këtij Ligji.

Padisë i ka bashkangjitur: kopjen e aktvendimit, datë 29 maj 2023 nr.03/1016/23 lëshuar nga Agjencia Kadastarle e Kosovës, me të cilin është aprovuar kërkesa e të paditurit 1, A G, mbi regjistrimin e pronës kontestuese pranë librave kadastar, kopjen e certifikatës pronësorë, së pronës kontestuese, datë 30 tetor 2023, e cila

evidentohet në emër të paditurit 2, F F R, kopja e kërkesës, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Graqanice, drejtuar AKP, datë 29 nëntor 2023, kopjen e listës poseduese, datë 2 shkurt 1995, lidhur me ngastrën kadastrale nr...., e evidentuar në emër të " J" Shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuar, kopjen e planit të ngastrës kadastrale nr...., kopjen e ortofotos, kopjen e udhëzimit të DHPGJS, C-IV-15-1607 dhe , kopjen e udhëzimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 27 shkurt 2023.

Më 23 janar 2024, gjykata lëshoj një urdhër për paditësin me të cilin ju kërkua që të parashtroje dhe sqaroj si në vijim:

Në pajtim me nenin 35 paragrafi 2.3 të Ligjit për DHPGJS, se padia me propozim mbi lëshimin e MS duhet të përmbajë adresën e saktë të paditurve, A G dhe F F G, e posaçërisht të paditurit 1 A G.

Të sqarohet se, gjersa paditësja në padi thekson se objekt kontesti është lokali afarist i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr...., Zona Kadastrale Prishtinë gjersa Vendimi i Agjencionit Kadastar bashkangjitur me padi, objekt i regjistrimit të paluajtshmerisë është në ngastrën kadastrale nr...., zona kadastrale Prishtinë. Nga gjitha këto arsye në kuptim të nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS. Paditëses po ashtu me urdhër të njëjtë i është kërkuar të parashtroj dhe dëshmojë me dëshmitë e kërkuara si në Urdhrin e dt. 23 janar 2024.

Me 02 shkurt 2024, paditësja është përgjigjur pjesërisht urdhrit të gjykatës, si në vijim:

Se nuk ka arritur të sigurojë kopjet e kontratave mbi shitblerjet, në mes të paditurit 1 A G dhe NSH " Grading" dhe kopjen e kontratës në mes të paditurve A G dhe F F G, dhe se ne ndërkohë posa të arrijë ta sigurojë do të parashtrojë edhe kopjet e kërkuara.

Lidhur me pjesën e urdhrit lidhur me lidhshmërinë juridike ndërmjet ngastrës gjendet objekt i kërkesës padisë- MS dhe ngastrës kadastrale nr...., Zona Kadastarle Prishtinë, të drejtën pronësisë së cilës e kërkon, paditësi pohon se

objekti i kërkesë padisë- MS dhe ngastrës kadastrale nr...., Zona Kadastrale Prishtinë, të drejtën e pronësisë së cilës e kërkon paditësja pohon se objekti kontestues gjendet në ngastrën kadastrale nr..... Sa i përket Kontratave të shitblerjeve, në mes të paditurit 1 A G dhe NSH " Grading" dhe kopjen e kontratës në mes të paditurve A G dhe F F G, paditësi pohon se kontratën e parë mes të paditurit 1 A G dhe NSH " Grading" nuk e posedon sepse nuk gjendet në arkiva të NSH-së, gjersa kopjen e dytë në mes të paditurve nuk mund ta sigurojë.

Paditësja nuk e kishte përmbushur urdhrin dhe nuk është deklaruar sa i përket, Pikës 1 të urdhrit (adresat e të Paditurit), pikës 2(kopjen e listës poseduese..., kopje kjo e fundit e jo edhe vitit 1995).

Me parashtrësë janë parashtruar dokumentacioni i njëjtë sikundër me padi si dhe kopjen e "SDR" (raporti përcaktues) të NSH " Jugoauto".

Me 04 mars 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-III-24-0012 Kërkesëpadinë si dhe propozimi mbi lëshimin e Masës së Sigurisë lidhur me njësinë kadastrale, Zona kadastrale Prishtinë, e ka hedhur si të papranueshme.

Në arsyetim të Aktvendimit thuhet se duke u bazuar në nenin 36.2 paragrafi 2.6 të Ligjit për DHPGJS një padi/ kërkesë mund të konsiderohet si e pranueshme, nëse:

" padia/kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji".

Tutje sipas nenit 35.2 paragrafi 2.3 të Ligjit për DHPGJS (nisja e procedurave), thuhet:

" padia duhet të përmbajë emrin dhe adresën e saktë të paditurit, deri në atë masë sa përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 25 të këtij ligji".

Shkalla e I-rë, e DHPGJS, ka arsyetuara se edhe përkundër tentimeve të gjykatës sipas urdhrit, datë 23 janar 2024, paditësja nuk ka e ka plotësuar kushtin ligjor mbi pranueshmerinë e padisë. Paditësja, me padi ka shënuar paditësin (A G) si të paditur por edhe përkundër kërkesës së gjykatës nuk ka ofruar adresën e saktë e

që gjykatës do ti mundësohej që padinë me MS njeherit të ja ofrojë të paditurit. Pra në rastin konkret, nuk është arritur to dorëzohet padia me MS njëherit i është pamundësuar që të deklarohet. Shkalla e I-rë ka vlerësuar se mos dhënia e mundësisë që të paditurit të informohen dhe të deklarohen paraqet shkelej të parimit: "*audiatur et altera pars apo audi alteram partem*" (le të dëgjohet edhe pala tjetër) andaj edhe në kuptim të dispozitave të lartë cekura ligjore të Ligjit për DHPGJS konsiderohet e pa pranueshme.

Shkalla e I-rë , po ashtu ka vlerësuar se paditësja gëzon të drejtën që të parashtrojë padi të re, por gjithnjë në pajtim me nenin 35.2 të Ligjit për DHPGJS.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se edhe pse kjo nuk është pjesë e këtij aktvendimi, padia në rastin konkret MS e propozuar gjithashtu duhet të përmbushë edhe kushtet tjera mbi pranueshmerinë, ato të parapara sipas nenit 35.2 paragrafi 2.4 ku thuhet se padia ndër tjerash duhet të përmbajë argumentet ligjore mbi te cilat mbështet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që paditësja synon ti paraqesë. Kjo veçanërisht për faktin se paditësi propozon lëshim të MS. Me padi kërkon njohjen e së drejtës së pronësisë së ngastrës kadastrarle gjersa në anën tjetër pohon se objekt i kërkesës padisë gjendet në ngastrën kadastrale nr..... Kjo nënkupton dy ngastra tjera kadastrale e që edhe përkundër kërkesës së gjykatës. Me anë të urdhrit, atë nuk e ka plotësuar por ka ofruar disa të dhëna kadastrale të vitit 1996. Paditësja kërkon anulim kontrate të lidhur në mes të paditurve në këtë rast atëherë gjykatës duhet ti ofrojë se kjo kontratë ekziston e jo thirret ashtu siç ceket edhe në padi" *ka pranuar informatë në rrugë jozyrtare*". Ky pohim duhet të vërtetohet nga ana e paditësit dhe duhet të vërtetohet gjithnjë me argumente ligjore e jo me informata jozyrtare.

Me 20 mars 2024, paditësja /ankuesja ka parashtuar ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktvendimit C-III.-24-0012 dhe ka propozuar qe të aprovohet ankesa e parashtuar nga Autoriteti i Likuidimit për NSH-në "Jugoauto", kundrejt Aktvendimit C-II.-24-0012 si të bazuar si dhe të shfuqizohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Autoriteti i Likuidimit thekson se gjykata me rastin e shqyrtimit të propozimit për masë të sigurisë ka marrë Aktvendim me të cilin e ka hedhur poshtë kërkesëpadinë

dhe propozimin për MS. Përgjatë leximit të arsytimit ligjor AL- ka vërejtur se që të dy kërkesat janë hedhur për arsye të pranueshme risë. Është kështu për shkak se Gjykata ka vlerësuar faktin se padia / kërkesa / ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme tutje sipas nenit 35.2 paragrafi 2.3 i Ligjit për DHPGJS-në përcakton se padia duhet te përmbajë emrin dhe adresën e saktë të paditurit. Padiësja konsideron se Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se Gjykata nuk është lëshuar fare në shqyrtim të gjitha fakteve të prezantuara nga na e propozuesit për caktim të masës së sigurisë, kështu nuk e ka vlerësuar drejtë faktet juridikë e rrjedhimisht nuk ka bërë vërtetim të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike.

Autoriteti i Likuidimit thekson se arsyeja se pse kanë munguar adresat e të paditurve në parashtrësën e dorëzuar, është për shkak se as për AL-ne nuk janë të njohura këto adresa.

Po ashtu AL-ja thekson se gjykata në vend që te hedhë kërkesëpadinë dhe propozimin për MS si të pa pranueshme është dashur që të veprojë në bazë të nenit 79.3a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili përcakton se : Gjykata do ti caktojë palës se paditur përfaqësuesin e përkohshëm, ndër të tjera edhe në rast:” në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë. k shtuar se AL-ja në lidhje me çështjen në fjalë i ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin që e ka në dispozicion. Andaj Agjencia Kosovare e Privatizimit në baze te detyrave të veta ekskluzive sa i përket ruajtjes se asteve që i ka ne administrim, përmes kësaj ankese kërkon rishikimin e Aktvendimit dhe vërtetimin e saktë të gjendjes faktike.

Me 04 prill 2024, i padituri i dytë nëpërmjet përfaqësuesit ka parashtruar përgjigjen në ankesë me të cilën ka propozuar që te refuzohet si e pa bazuar ankesa e padiësit/propozuesit dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar, i padituri në ankesën e parashtruar e kundërshton ankesën e padiësës pasi që sipas te paditurit Aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm me që çështjet e ngritura lidhur me provueshmërinë e padisë dhe propozimit për mase te sigurisë janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe ngërthejnë në vete elemente procedurale të cilat padiësi nuk ka arritur në asnjë forme ti arsyetoje dhe paraqesë. Tutja ka theksuar se ankesa e padiësës është ne tersi e pa bazuar dhe pretendimet në ankesë janë

vetëm një tendencë për të dëmtuar të paditurin. Së pari, duke filluar nga mënyra e inicimit të kësaj procedure, ashtu siç e thekson vet paditësi/propozuesi, përmes informatave të marra në rrugë jo-zyrtare, dëshmon qartë mos-seriozitetin e paditësit/propozuesit. Vet togfjalësh" nëpërmjet informatave jo zyrtare" tek i padituri/ kunderpropzuesi krijon dilema lidhur me paanshmërinë dhe profesionalizimin e paditësit/propozuesit si në institucion shtetëror. I padituri/ kunderpropzuesi thekson se janë pikërisht personat në rrugë jo-zyrtare që i kanë dhënë informacion paditësit, ata që kanë interesa direkte pronësore dhe vet presioni për inicimin kësaj procedure kontestimore ka ardhur nga burimi anonim i paditësit/propozuesit.

Së dyti, paditësja/propozuesja nuk ka arritur të ofrojë asnjë prove e cila e dëshmon kundërligjshmërinë e transaksionit të paluajtshmerisë kontestuese tek i padituri duke filluar nga prova kryesore- Kontrata e nënshkruar nga i padituri/ kundërpropozuesi në cilësi të blerësit.

Sa i përket pretendimeve procedurale, i padituri thekson se ankesa e paditësit është tërësisht e pa bazuar dhe është parashtruar vetëm për ta plotësuar një kusht procedural. Përfaqësuesi i përkohshëm sipas ligjit Nr.03/L006 për procedurën Kontestimore, caktohet nga Gjykata në rast se pala në procedurë nuk ka adresë të njohur për gjykatën. Megjithatë, procedura kontestimore zhvillohet sipas kërkesës të palëve dhe nuk mundet që Gjykata të marrë rol proaktiv për krijimin e kushteve procedurale për një palë të caktuar në procedurë. Neni 2 të këtij ligji e thekson, se Gjykata vendosë vetëm brenda kërkesave të palëve. Në propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm nga paditësi nuk është parashtruar asnjëherë-andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

I padituri po ashtu thekson se paditësi nuk e ka te qarte se në cilën ngastër kadastrale gjendet paluajtshmeria kontestuese dhe nuk ka theksuar fare nëse kërkesa e tij është vendosja e masës mbi objektin apo ngastrën kadastrale-meqë të dyja këto identifikohen me shenja të ndryshme. Po ashtu ka theksuar se paditësja përveç qe nuk e ka bere te besueshme të drejtën subjektive me asnjë provë- e cila është konstatuar edhe nga Gjykata- i njëjti nuk e ka plotësuar as kushtin e dëmit të pariparueshëm. Paditësja nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me demin që mund t'i shkaktohet. I ka propozuar Kolegjit te Apelit që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja më 22 janar 2024, parashtroi padi me propozimin për lëshimin e masës se sigurisë. Paditësja me padi kërkon anulimin e Kontratës së shitblerjes nr.... datë . prill të lidhur në mes të NSH " Grading" dhe të paditurit 1, A G, si dhe vërtetimin e së drejtës së pronësisë të njësisë kadastrale nr....., Zona kadastrale Prishtinë. Me propozimin për lëshimin e Masës se sigurimit ka kërkuara që të urdhërohen të paditurit që mos të ndërmarrin asnjë veprim në pronën kontestuese e gjerë në zgjidhjen përfundimtare lidhur me çështjen.

Me 04 mars 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-III-24-0012 Kërkesëpadinë si dhe propozimi mbi lëshimin e Masës së Sigurisë lidhur me njësinë kadastrale, Zona kadastrale Prishtinë, e ka hedhur si të papranueshme.

Kolegji i Apelit vëren se me 23 janar 2024, Shkalla e I-rë ka lëshuar urdhër për paditësen dhe përveç sqarimeve dhe dëshmive që kishte kërkuar në pikat tjera të urdhrit paditëses, në piken 1 i ishte kërkuar që ta jep adresën e saktë të paditurve, A G dhe F F G, e posaçërisht të paditurit 1 A G. Po ashtu Kolegji vëren se me këtë urdhër ishte njoftuar paditësja se nëse nuk e përmbush urdhrin e gjykatës në të gjitha kushtet të cekuar si në urdhër, padia së bashku me propozimin për masën e sigurimit mund të hedhen poshtë si të papranueshme.

Kolegji i Apelit vëren se me dt. 02 shkurt 2024, paditësja ka paraqitur një përgjigje, mirëpo e njëjta nuk është deklaruar fare sa i përket, pikës 1 të urdhrit lidhur me adresën për të paditurve e posaçërisht për adresën e të paditurit të parë A G, edhe pse ishte paralajmëruar me urdhër për pasojat e hedhjes së padisë dhe kërkesës për masë të sigurimit. Madje Kolegji vëren se Shkalla e I-rë me urdhër i ishte referuara edhe neneve përkatëse, përkatësisht nenit 35 paragrafi 2.3 të Ligjit për DHPGJS, i cili nën përcakton se çka duhet të përmbaj një padi, krekës apo ankesë. E paditura nuk është palë laike por konsiderohet se është njohëse e mire e çështjeve ligjore dhe procedurale, andaj lëshimet e tilla nuk mund të tolerohen.

Kolegji i Apelit vëren se nenin 36 pika 2.5 e Ligjit nr. 06/L-086 të DHPGJS përcakton se një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse kërkesa apo ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të Ligjit për DHPGJS. Po ashtu Kolegji vëren se nenin 36.3 i të njëjtit Ligj përcakton se:

"Nëse Gjyqtari i vetëm apo Kolegji, vlerëson se kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni nuk janë përmbushur, atëherë ai hedh poshtë kërkesën/ankesën në baza të papranueshmërisë si dhe saktëson në hollësi bazën ligjore për refuzimin e tillë. Nëse kërkesa/ ankesa refuzohet vetëm për shkak se nuk i përmbahet nën-paragrafi 2.5 të këtij neni, atëherë Gjyqtari i vetëm apo Kolegji do t'i lëshojë një urdhër paditësit me të cilin saktësohet afati i arsyeshëm kohor brenda të cilit Paditësi mund të korrigjojë gabimet dhe prapë të parashtrtojë kërkesën/ankesën".

Shkalla e I-rë siç edhe kemi theksuar me lartë kishte lëshuar urdhër për paditësen në mënyrë që siguroj adresat e të paditurve por paditësja nuk ishte përgjigjur lidhur me këtë pikë, përkatësisht nuk ishte deklaruar fare, andaj Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë me të drejte ka zbatuar dispozita përkatëse të Ligjit për DHPGJS lidhur me kriteret e pranueshmërisë së kërkesës së paditësit duke e hedhur padinë dhe masën e sigurimit si të papranueshëme. Me të drejtë Shkalla e I-rë në arsyetimin e Aktvendimit ka potencuar se në mungesë të adresës së saktë të paditurit nuk i ishte e mundur të informohen dhe të deklarohet për kërkesën e paditëses. Kjo është edhe një nga arsyet se pse Ligjvënësi ka përcaktuar kriteret e pranueshmëris me

nenin 36.2 të Ligjit për DHPGJS kur një kërkesë/ankesë mund të konsiderohet e pranueshme.

Pretendimet e paditëses të ngritura me ankesë, se Shkalla e I-rë është dashur të caktoj përfaqësues të përkohshëm për të paditurit është e pathemeltë, kjo pasi që paditësja nuk është përgjigjur për piken 1 të urdhrit të Shkallës së I-rë të dt. 23 janar 2024, lidhur me adresat e të paditurve. Paditësja as me padi por as me përgjigjen e saj ndaj urdhrit nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të siguruar adresat e të paditurve përkatësit të padituri të parë, madje ajo as nuk kishte paraqitur kërkesë në Shkallën e I-rë për të kërkuara caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, prandaj pretendimet e tilla të ngritura me ankesë në Shkallën e II-të sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit janë të pabazuar.

Ashtu siç ka theksuar Shkalla e I-rë e DHPGJS , edhe Kolegji i Apelit konsideron se paditësja mund të paraqes një padi të re në Gjykatë, sepse çështja e saj juridike nuk është vendosur në merita, por kuptohet gjithnjë në pajtim me nenin 35.2 të Ligjit të DHPGJS,

Nga këto arsye, ankesa e paditëses është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 02 prill 2024, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____